

UDHËZUES PËR PRINDËRIT NË PERIUdhËN E KALIMIT

# NGA KOPËSHTI I FËMIJËVE NË SHKOLLË

Vorwort Pröll:

Të dashur prindër!

Viti i fundit në kopësht e fëmijëve si dhe viti i regjistrimit në shkolla është mjaft i veçantë. Fëmija juaj konverton nga fëmijë e vogël në fëmijë shkolle, largohet nga mjedisi i njohur i kopështit dhe futet në një fazë të re të jetës, në atë shkollore.

Kalimi nga kopështi në shkollë do të sjellë detyra të reja për fëmijët dhe familjen— detyra këto që do të kryen sëbashku. Me përfshirjen tuaj si prindër do të ndikoni në proceset mësimore dhe në karrierën e mëvonëshme të fëmijës tuaj.

Ekspertë të kopështeve dhe shkollave fillore, kanë përpunuar për këtë qëllim një udhëzues, që do tju shoqërojë dhe ndihmojë në rrugën tuaj. Shkollat tona afrojnë një shumëllojshmëri mundësish, me qëllim që fëmija juaj të zhvillojë potencialin e tij individual. Në qëndër të vëmëndjes këtu, është të mësuarit me dëshirë dhe ndërtimi i kompetencave sociale. Aftësitë e fituara gjatë mësimit dhe lojës elementare në kopështin e fëmijëve, përbëjnë dhe bazën e të mësuarit në shkollë.

Udhëzuesi "Nga kopshti në shkollë", jep një informacion të plotë të periudhës derisa fëmija të futet në shkollë. Ai ju jep mundësinë e një vështrimi të lojrave dhe të përvojës mësimore në kopësht, si dhe të drejtimit zhvillues dhe atij mësimor në shkollën fillore.

Ai përmban gjithashtu dhe shumë këshilla praktike, në drejtim të mbështetjes së fëmijës tuaj në familje. Përveç kësaj, ju do të gjeni aty dhe informacione të vlefshme në kuadrin ligjor, të kontakteve dhe të literaturës përkatëse.

Të dashur prindër, ky udhëzues le të jetë për ju, një mbështetje dhe ndihmë, për një kalim sa më të harmonizuar të fëmijës tuaj nga kopështi në shkollë. Fëmijës tuaj i uroj, që gjatë vitit të fundit në kopësht, të presi me gëzim dhe entuziazëm fillimin e vitit të ri shkolllor. Gjithë të mirat!

DR. ERWIN PRÖLL

Landeshauptmann von Niederösterreich

Vorwort Schwarz:

Kopështi, është një institucion i rëndësishëm dhe domethënës për të gjithë fëmijët e moshës 2,5 - 6 vjeçare, që do tju mbështesë ju si prindër për edukimin dhe arsimimin e fëmijës tuaj. Si Landesrätin përkatëse për shkollat dhe kopështet, i jap rëndësi të veçantë faktit, që familja duhet të jetë e bindur se fëmijët e tyre, do trajtohen me kujdes dhe dashuri të veçantë nga personeli pedagogjik.

Kujdes i madh në kopështin e fëmijëve i jepet sigurisht kualitetit pedagogjik dhe kujdesit individual për të vegjëlit tanë, sepse ata duhet të trajtohen në bazë të talentit, të dhënave dhe interesave të tyre të veçanta në mënyre optimale.

Fëmija juaj qëndron përpara kalimit për në shkollë – një hap ky, që pedagogët e kopështeve dhe shkollave si dhe ju si prindër do ta përgatisni sëbashku. Fëmija juaj po përballë me kohën e ndryshimeve. Tamam tani është i domosdoshëm një bashkpunim i ngushtë dhe një vizion i përbashkët, për të përcjellë tek fëmija juaj ndjenjën e mirë të sigurisë.

Ju si prindër, jeni mbështetja më e çmuar e fëmijës tuaj, gjatë periudhës së kalimit nga kopështi në shkollë.

Unë ju ftoj, që këtë kalim të djalit apo vajzës tuaj, ta përgatisni sëbashku me ta në mënyrë sa më pozitive. Përgatitjet e përbashkëta për në shkollë si dhe trasmetimi i dëshirës për të mësuar, do ta bëjnë më të lehtë fillimin e mbarë të shkollës.

Në këtë udhëzues do të gjeni fakte dhe këshilla interesante, që do tju ndihmojnë juve për të zhvilluar potencialin e fëmijës tuaj. Ai do të ndihmojë gjithashtu, fëmijën tuaj - dhe ju vetë - për tu parapregatitur kompetent dhe sa më mirë për fillimin e shkollës.

Më lejoni që të shfrytëzoj mundësinë për tju falemnderuar juve, për mundimin që ju është dashur, në zbulimin e talentit dhe potencialit të fëmijës tuaj.

MAG. BARBARA SCHWARZ

Landesrätin für Familie, Soziales und Arbeitsmarkt

Tabela e përmbajtjes:

TË PROJEKTOJMË SËBASHKU FAZËN KALIMTARE	6
BISEDAT PËR FAZËN KALIMTARE	9
FAZA E FILLIMIT TË SHKOLLËS	10
PLANI ARSIMOR PËR KOPËSHTET NË NIEDERÖSTERREICH	12
DOMETHËNJA E LOJRAVE	14
EMOCIONET DHE MARDHËNJET SHOQËRORE NË ARSIM	16
ETIKA;FEJA DHE SHOQËRIA NË ARSIM	18
GJUHA DHE KOMUNIKIMI NË ARSIM	20
LËVIZJA DHE SHËNDETI NË ARSIM	24
ESTETIKA DHE PROJEKTIMI NË ARSIM	26
NATYRA DHE TEKNIKA NË ARSIM	28
PYETJET PËR KOPËSHTIN	32
PYETJET PËR SHKOLLËN	33
BURIMET E TË DHËNAVE	34
TE DHËNAT E LITERATURES PËR PRINDËRIT	35

Seite 6

TË PROJEKTOJMË SËBASHKU  
FAZËN KALIMTARE

„ZBULIME TË SHUMTA GJATË  
RRUGËS, NGA KOPËSHTI  
I FËMIJËVE PËR NË SHKOLLË“

Nëqoftëse ju do të kujtoheni  
për ditët e para të shkollës,  
do të mendoni ndoshta  
dhe sa krenarë ndjeheshit,  
që më në fund ishit dhe ju  
një nxënës shkolle,  
ose shqetësimin që kishit,  
nëse mësuesit dhe fëmijët  
e tjerë do të ishin ,apo jo,  
të sjellshëm me ju.

Kështu edhe fëmija juaj,  
do ta fillojë shkollën,  
me një kompleks mendimesh  
dhe ndjenjash të ndryshme.  
Këtu peshon më shumë, gëzimi  
dhe kureshtja.Por ndryshimet  
e mëdha sjellin tek fëmijët,  
ku më shumë e ku më pak edhe  
shqetësime e pasiguri,prandaj

**gjatë kalimit nga kopështi në shkollë,  
janë disa detyra për tu kryer :**

3 Përshëndetja e ndarjes nga fëmijët

dhe të rriturit e kopështit

3 Ndërtimi i mardhënjeve të reja

me fëmijët dhe të rriturit në shkollë

3 Të mësuarit me faktin, që nga një

fëmijë shkolle pritet diçka tjetër

3 Të ndjerit mirë, në ambjentet

dhe jetën e përditëshme në shkollë

3 Mësimi i shkrimit, leximit dhe

numërimit

**Ballafaqimi me këto detyra, është një domosdoshmëri**

**për çdo fëmijë dhe familjen e tij. Kryerja e këtyre detyrave**

**forcon fëmijët dhe çon përpara zhvillimin e tyre.**

Fëmija juaj, ka mbledhur tashmë përvojë në trajtimin

e situatave kalimtare, përshëmbull hyrjen në kopësht ose

lindjen e vëllait apo motrës. Çdo kalim i zotëruar me sukses,

forcon aftësinë e fëmijëve për të zotëruar edhe

kalime apo ndryshime të tjera.

Ndihmojeni fëmijën tuaj dhe besojini atij

që edhe kalimin në shkollë do ta bëjë me sukses.

Kini kujdes, kur të flisni për shkollën.

Thënjat si „Tashti fillon jetë e vështirë për ty“

ose „Prit, sa të shkosh në shkollë dhe do ta shikosh“

sjellin pasiguri dhe i vënë fëmijët nën presion.

**Qëndrimi juaj pozitiv si prindër kundrejt shkollës dhe mësimit, i përcillet dhe fëmijës tuaj. Shikojeni fillimin e shkollës me gëzim, kureshtje dhe optimizëm.**

Seite 7

## KËSHTU MUND TA MBËSHTESNI FËMIJEN TUAJ

### **3 Mbështeteni fëmijën në zhvillimin e tij.**

Në jetën e përditëshme ka mundësira të gjithanëshme, që mund të shfrytëzohen për të ndihmuar dhe parapregatitur fëmijën për kërkesat e shkollës. I detë dhe sugjerimet do ti gjeni në këtë udhëzues.

### **3 Përgatitje për jetën shkollore.**

Shkuarja në kopësht rregullisht, të veshurit dhe të çveshurit vetë, detyra dhe detyrime të vogla të dhëna simbas moshës, të mësuarit e rrugës për në shkollë, zgjedhja vetë e çantës së shkollës, përgatitja sëbashku për “vëndin e punës” shkuarja për gjumë dhe zgjimi në kohën e duhur.

### **3 E panjohura të bëhet e njohur**

Ndihmoni bashkpunimin ndërmjet kopështit dhe shkollës. Bisedoni me

fëmijën për fillimin e shkollës, përgjigjuni  
pyetjeve të tij - këtu do tju ndihmojnë  
shumë dhe librat me figura. Shfrytëzoni  
mundësitë e vizitave dhe festave në  
shkollë, me qëllim që fëmija juaj të njohë  
„botën e re shkollore“.

#### ÇFARË THONË FËMIJËT E KOPËSHTIT:

##### **Në kopësht unë kam mësuar:**

„**Të vizatoj, të ndërtoj dhe të ngjitem shumë mirë.**“ (Kerstin, 6 Jahre)

„**Që të di shumë.**“ (Julia, 6 Jahre)

„**Të dëgjoj kur flet një tjetër.**“ (Fabian, 6 Jahre)

„**Të kem durim.**“ (Milena, 6 Jahre)

##### **Në shkollë dua të mësoj:**

„**Mjeshtërinë dhe llogaritjen.**“ (Max, 6 Jahre)

„**Të gjitha ato gjëra, që nuk i di akoma.**“ (Kerstin, 6 Jahre)

##### **Unë dëshiroj nga shkolla:**

„**Nota të mira.**“ (Jakob, 6 Jahre)

„**Që shkolla ime të jetë tepër miqësore.**“ (Perdita, 6 Jahre)

„**Që të gjej shokë të rinj.**“ (Julia, 6 Jahre)

## VITI I FUNDIT NË KOPËSHTIN E FËMIJËVE

Proçesi i mësimi në kopësht, fillon me ditën e parë të kopështit dhe vazhdon sigurisht me parapregatitjet për futjen në shkollë.

Viti i fundit në kopësht ka domethënje të madhe, sepse fëmijët në këtë vit do të marrin një nxitje speciale, që do ti ndihmojë të bëjnë sa më mirë kalimin nga kopështi në shkollë.

## VITI I FUNDIT NË KOPËSHT ËSHTË I DETYRUAR

Për të krijuar shanse të njëjta për çdo fëmijë, duhet që ata të marrin pjesë rregullisht në procesin mësimor. Prandaj dhe pjesmarrja në vitin e fundit në kopësht, është bërë e detyruar.

### **Kopështi i detyruar përfshin**

në vitin e fundit përpara hyrjes në shkollë, pjesmarrjen e detyruar dhe pa pagesë në kopësht, për **16 orë në javë**, të bëra këto në sëpaku katër ditë gjatë procesit mësimor.



## NË VITIN E FUNDIT TË KOPËSHTIT TË FËMIJËVE

3 Proçese mësimore speciale, vetëm për „të mëdhenjtë“

3 Aktivitete mësimore që mbështesin periudhën kalimtare.

(p.sh. biseda me fëmijët për këtë temë,  
biseda me prindërit, mbledhje me prindërit,  
bashkpunim me shkollën)

3 Biseda për pyetjet që mund të dalin në  
drejtim të hyrjes në shkollë

Në kuadrin e një projekti bashkpunues,  
fëmijët e kopështit vizitojnë shkollën

Seite 9

## BISEDAT PËR PERIUDHËN KALIMTARE

Në shumicën e fëmijëve, kalimi nga  
kopështi në shkollë ndodh pa probleme.

Në lidhje me shqetësimet që mund të keni;  
për zhvillimin e fëmijës tuaj dhe pyetjet që  
mund tju lindin për mënyrat e shkollimit të tij,  
do tju jepet mundësia e një **bisede** sqaruese.

## KUSH MERR PJESË NË BISEDAT

### PËR PERIUDHËN KALIMTARE?

Në bisedat për periudhën kalimtare, marrin pjesë prindërit si dhe personat që përfaqësojnë kopështin dhe shkollën. Në këtë bisedë, mund të marrin pjesë dhe persona të tjerë që kujdesen për fëmijën tuaj.

## SI MUND TË KËRKOHET BISEDA

### E PERIUDHËN KALIMTARE?

Nëqoftëse ju si prindër, dëshironi të bëni një bisedë për periudhën kalimtare, drejtohuni ju lutem në drejtorinë e kopështit. Kjo do të organizojë hapat e duhura për organizimin e bisedës. Nëqoftëse inisiativa për këtë bisedë vjen nga kopështi apo shkolla, atëhere pedagogët drejtohen tek prindërit. Nëqoftëse prindërit janë dakort, atëhere mundësohet dhe bërja e një termini të përbashkët.

## CFARË PËRMBAN BISEDA PËR

### PERIUDHËN KALIMTARE?

3 Bisedë për shkollën e zhvillimit të fëmijës.

Çfarë di ai shumë mirë? Ku kërkon më shumë mbështetje? Çfarë i duhet atij për të mësuar mirë?

3 Informacionet dhe ndihma për vendimet, që kanë të bëjnë me hyrjen në shkollë

3 Nëqoftëse kërkohen masa mbështetëse ose kushte të tjera speciale, duhet që këto të mendohen dhe planifikohen sëbashku

„SËBASHKU

TË PLANIFIKOJMË

FILLIMIN E SHKOLLËS“

Vizatimi: Hannah

Seite 10

## FAZA E FILLIMIT TË SHKOLLËS

### HAPI I PARË

#### REGJISTRIMI NË SHKOLLË

Nëqoftëse fëmija juaj, deri në 31 gusht ka mbushur 6 vjeç, duhet që në 1. shtator të përfillojë vitin e fillimit të shkollës.

Çdo fëmijë që ka mbushur moshën, do të merret në shkollë dhe do mbështetet në përputhje me të dhënat dhe nevojat që ka.

Regjistrimi i fëmijës në shkollë, (Schulereinschreibung)

do të bëhet në shkollën përkatëse.

Se kur bëhen regjistrimet në shkollë dhe çfarë dokumentash duhet të keni me vete, do ta mësoni nga shkolla përkatëse ose nga zyra e komunës.

Është e rëndësishme që gjatë regjistrimit, fëmijën ta keni me vete. Përveç marrjes formale në shkollë, kjo ka të bëjë dhe me njohjen e njëri-tjetrit si dhe me vlerësimin e parë, nëse fëmija juaj mund të ndjekë mësimin e klasës së parë pa u mbingarkuar.

Në javët e para, duhet që fëmijës ti jepet koha dhe mundësia, për tu njojtur me fëmijët e tjerë me mësuesit apo mësueset, gjithashtu dhe me ndërtesën e shkollës si dhe orarin e saj .

## DER SCHULBEGINN

Një fillim i mirë i shkollës, ndikon shumë edhe për vazhdimin e mirë të saj si dhe për të mësuarit me dëshirë.

## „NJË FILLIM POZITIV I SHKOLLËS PËR TË GJITHË FËMIJËT“

Fëmijët ndryshojnë nga njeri tjetri për sa i përket kohës së të mësuarit, dëshirës për të mësuar,

aftësisë për të komunikuar si dhe në lidhje me punën e pavarur. Ata kanë interesa të ndryshme dhe sjellin përvoja të ndryshme me vete.

Mësuesja ose mësuesi, orientohet nga kushtet individuale të të mësuarit të fëmijëve dhe i merr parasysh ato gjatë mësimit.

Duke u nisur nga format e njohura të lojës dhe të të mësuarit, fëmijët do të futen gradualisht në format e reja të mësimdhënjes.

Faza e fillimit të shkollës bën të mundur, që duke u bazuar në kohën që i duhet çdo fëmije për të përpunuar materialet mësimore, për dy vitet e para shkollore, të ketë tre vjet në dispozicion.

Po të shikohet, se fëmija në klasën e parë është i mbingarkuar nga materialet mësimore, atëherë ai kalohet në fazën e parashkollimit.

Faza parashkollore do të shikohet si pjesë e shkollës fillore dhe mund të jetë

3 si klasë e veçantë parashkollore

3 ose sëbashku me klasën e parë dhe të dytë.

Klasa parashkollore do të llogaritet në vitet e pjesmarrjes së detyrueshme të shkollës.

Për të ndaluar mbingarkesën ose nëngarkesën  
e fëmijës, është e mundur që ndryshimet të  
bëhen edhe gjatë vitit shkollor.

Dizpozitat ligjore mund të lexohen në ligjet

shtetërore të shkollës së detyruar.

(Schulpflichtgesetz 1985), BGBl. Nr. 76/1985

për momentin në versionin e ndryshuar.

Informacione të tjera :

[http://www.bmukk.gv.at/schulen/service/schulinfo/aufnahme\\_vs](http://www.bmukk.gv.at/schulen/service/schulinfo/aufnahme_vs).

Seite 13

## PLANI MËSIMOR PËR KOPËSHTET E FËMIJËVE NË NÖ

KOPËSHTI I FËMIJËVE – VËND PËR TË LUAJTUR,  
PËR TË MËSUAR DHE PËR TU NDJERË MIRË

Në fëmëinë e herëshme do të vihen gurët themeltarë  
për arsimin dhe mësimin. Kopështi luan një rol të  
rëndësishëm në rrugën arsimore të fëmijëve.

## PLANI ARSIMOR

3 tregon, sesi do ndihmohen fëmijet në kopësht

për zhvillimin e tyre

3 është bazë për punën pedagogjike me

fëmijët

3 jep një vështrim në punën dhe proceset

mësimore në kopësht

3 përmban sugjerime pedagogjike dhe

metodike

3 vendos një urë kalimi ndërmjet kopështit

dhe shkollës

Në fushat e përmëndura të planit arsimor,  
në faqet shpjeguese të mëposhtëme, do të gjeni  
sugjerime dhe shëmbuj se si do të ndihmohen  
dhe mbështeten fëmijët tuaj për  
zhvillimin e tyre në kopësht.

Plani arsimor për kopështet e fëmijëve në Niederösterreich

<http://www.noe.gv.at/Kindergaerten>

**Drejtimi arsimor**

**Ndjenjat dhe marrdhënjet**

**shoqërore**

Faqe 16

**Drejtimi arsimor**

**Etika, religioni dhe**

**shoqëria**

Faqe 18

**Drejtimi arsimor**

**Gjuha dhe**

**komunikacioni**

Faqe 20

**Drejtimi arsimor**

**Lëvizja dhe**

**shëndeti**

Faqe 24

**Drejtimi arsimor**

**Estetika dhe**

**projektimi**

Faqe 26

**Drejtimi arsimor**

**Natyra dhe teknika**

Faqe 28



## DOMETHËNJA E LOJËS

**Loja është një nga aktivitetet kryesore të fëmijës. Expertët mendojnë se fëmijët deri në moshën 6-vjecare luajnë (duhet) 15.000 orë. Këto janë 7 - 8 orë në ditë.**

Sepse loja ju jep atyre jo vetëm kënaqësi, por është dhe rruga e drejtë,

3 për të arritur dhe ushtruar aftësitë dhe shkathtësitë

3 për të përpunuar ndjenjat

3 për të përballuar konfliktet

3 për të zhvilluar durimin, koncentracionin

si dhe qëndrimin ndaj punës

3 për të mësuar rregullat e mirësjelljes shoqërore

(p.sh. ti përmbahet marrëveshjeve)

3 për të përpunuar përshtypjet

3 për të përmirësuar aftësitë motorike

dhe ndjenjën trupore

3 për të testuar mënyrën e të sjellurit

3 për ta bërë të pakuptueshmen, të

kuptueshme

**Gjatë lojës fëmijët mbledhin përvojën  
themelore,për të përvetësuar aftësitë  
dhe shkathtësitë e duhura për shkollën.**

Dy shëmbuj: Gjatë lojës me rërë dhe ujë,fëmijët mbledhin përvojën që ka lidhje me shumën dhe masën.Të dhënat e fituara këtu do i ndihmojnë ata më vonë,për të zgjidhur detyrat e matematikës.

Gjatë lojës me top,fëmijët mësojnë ndërmjet të tjerave, kordinimin e lëvizjes së duarve dhe të syve – kjo është një bazë e rëndësishme për procesin e shkrimit dhe leximit.

Përjetoni me fëmijën tuaj aspektet e shumta të lojës: Të luajturit me role të ndryshme,lojra me figura,lojra ndërtuese,modele me gura, lojra me karta ose lojra tavoline,këngë, valle dhe vjersha etj.

„TË LUAJTURIT  
ËSHTE MËSIM“

# KOPËSHTI I FËMIJËVE

## FAMILJA

## SHKOLLA

### PËRVOJA E LOJËS DHE MËSIMIT NË KOPËSHT

#### **Forma loje të lira dhe**

#### **të drejtuara:**

- 3 Lojra zbuluese dhe perceptuese
- 3 Lojra projektuese dhe muzikore
- 3 Lojra konstruksioni dhe ndërtimi
- 3 Lojra vendosëse dhe strategjike
- 3 Lojra shkathtësuese dhe lëvizëse
- 3 Lojra me gishta dhe me kukulla dore
- 3 Lojra me role të ndryshme
- 3 Lojra të shpejta dhe të qeta
  
- 3 Lojra gjuhësore, vjersha,  
gjëagjëza dhe libra me figura
- 3 Lojra shoqërore
- 3 Lojra tavoline dhe lojra me rregulla

## KËSHTU E NDIHMONI

### FËMIJEN TUAJ NË FAMILJE

3 I lini fëmijës tuaj kohë për të luajtur, me qëllim që përvojën e fituar aty,ta zhvillojë dhe thellojë akoma më tutje.

3 Lëreni fëmijën të luajë deri në fund, nëqoftëse është futur thellë në lojën e filluar.

3 Mundësohuni fëmijës kontakte me fëmijë të tjerë.Gjatë lojës me fëmijë të tjerë, ai do të mësojë dhe ushtrojë rregullat e rëndësishme shoqërore të mirësjelljes.

3 Ndhmoni fëmijën tuaj në zbulimet që bën, ai duhet të ketë mundësinë të provojë, të kërkojë, të gjejë, të mbledhë dhe të organizojë.

## DETYRAT MËSIMORE DHE

### ZHVILLUESE NË SHKOLLË

Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara gjatë lojës formojnë bazën për

3 mësimin e kulturtechnikës

elementare (leximi,shkrimi

dhe llogaritja)

3 shpalosjen e të mësuarit me

dëshirë dhe në mënyrë të pavarur

3 të përshtaturit e mësimin dhe

punës në lidhje me durimin, kujdesin

koncentracionin, saktësinë,ndihmën

dhe konsideratën për të tjerët

3 aftësia e të vepruarit social

(bashkpunimi, zhvillimi dhe njohja

e rregullave dhe normave)

Seite 16

EMOCIONET DHE MARDHËNJET

SHOQËRORE NË ARSIM

„ÇFARË I FORCON

FËMIJËT

„Në të vërtetë çdo fëmijë kërkon tre gjëra“

thotë Neurobiologu Prof. Dr. Gerald Hüther:

**„ai kërkon detyra, nëpërmjet të cilave rritet,  
ai kërkon modele, nëpërmjet të cilave  
orientohet dhe ai kërkon bashkësi, ku të  
mund të ndjehet mirë.“**

Familja, është bashkësia e parë ku fëmijët  
fitojnë përvojën e sigurisë si dhe gjejnë modelet  
e tyre për të përballuar situatat e mëvonëshme.

Që të mund të rriten nëpërmjet detyrave, fëmijët  
kërkojnë mundësi të shumëllojshme, mundësinë  
për të provuar vetë, të veprojnë të pavarur në  
mënyrë që të përjetojnë faktin, që veprimi i tyre  
mund të ndryshojë diçka. Të mbulojë tavolinën, të  
nguli gozhdën ose të gjejë pse nuk funksionon  
më zilha e biçikletës, i bën fëmijët krenar dhe ju  
forcon besimin në vetvete.

**Përvojat „Unë mund të ndryshoj diçka“ –**

**„Unë jam i vlefshëm“ – „Unë perceptohem si person“**

**ju japin fëmijëve sigurinë në vetvete.**

Fëmijët që zotërojnë qëndrime të tilla pozitive,  
i shikojnë vështirësitë si piksynime dhe

i përballojnë periudhat kalimtare si ajo e kalimit nga kopështi në shkollë me lehtësi.

Kopështi ju afron fëmijëve shansin për të përjetuar një bashkësi të madhe, për të ndërtuar marrdhënje me fëmijë dhe me të rritur, si dhe për të lidhur miqësi me ta. Në kopësht kanë mundësinë të veprojnë në bazë të rregullave dhe të përpunojnë kontradiktat. Aty fëmijët mësojnë të përshtaten grupit, të ngrejnjë kërkesat e tyre, të bashkëpunojnë me të tjerët për të realizuar idetë e tyre.

E gjithë kjo përvojë, që ka lidhje me veten dhe me bashkëjetesën me të tjerë, formon një bazë të rëndësishme për jetën dhe mësimin në shkollë.

Seite 17

## PËRVOJA E LOJËS

## DHE MËSIMIT NË KOPËSHT

### **3 Zhvillimi i figurës së vetvetes**

Njohja e forcave të veta dhe sjellja e tyre në grup, marrja e përgjegjësisë, zhvillimi i ndjenjës se si mund të ndikoj unë tek të tjerët

### **3 Përjetimi i bashkësisë**

Të ndjerit mirë në bashkësi,  
kërkimi i vëndit të vet në grup,  
zhvillimi i antarësisë në grup,  
p.sh. të organizuarit sëbashku  
të ditës në kopësht, të luajturit  
sëbashku, festimi i festave,të  
punuarit sëbashku p.sh. në  
punë bujqësore, të organizuarit  
e një expozite,mbarimi vetë i  
një libri me figura,.....

### **Bashkpunimi dhe kontradiktat**

Të bërit e marrëveshjeve në grup,  
gjetja e rrugëve për të zgjidhur  
situatat kontradiktore, p.sh. nëpërmjet  
futjes në role të ndryshme,  
librave me figura,bisedave

## **KËSHTU E NDIHMONI FËMIJËN**

### **TUJ NË FAMILJE**

### **3 Dhurimi i dashurisë dhe besimit**

Akceptoni fëmijën tuaj me të gjitha  
ndjenjat e tij,të mirat dhe të ligat e tij.  
I tregoni fëmijës se e doni dhe kini  
besim tek ai



### **3 Merrni kohë, dëgjoni**

Planifikoni një kohë të caktuar  
për lojra të përbashkëta dhe  
biseda, për të ngrënë sëbashku,  
dhe për të fjetur

### **3 Caktoni kufirin**

Caktoni me fëmijën marrëveshje  
të qarta dhe kujdesuni me durim  
dhe vendosmëri, që ata ti  
përmbahen atyre

### **3 Dhënja e hapësirës**

Për të provuar vetë si dhe mundësinë  
për të bërë edhe gabime.

### **3 Zgjidhja e kontradiktave**

Edhe për tu grindur duhet mësuar: Mundësia  
për të thënë „jo“, të shprehurit e ndjenjave  
me masë, gjetja e kompromiseve,....

DETYRAT MËSIMORE DHE  
ZHVILLUESE NË SHKOLLË

### **3 Mbështetja e personalitetit**

#### **të fëmijëve**

Forcimi i besimit në vetvete dhe  
zhvillimi i të kuptuarit të të tjerëve

### 3 Të mësuarit social

Të mësuarit me - dhe nga të tjerët,  
ndihma reciproke dhe mbështetja

### 3 Zhvillimi i mëtejshëm i mirësjelljes

shoqërore, zhvillimi dhe akceptimi

i rregullave ose i rregullores

si kusht për mësimin

### 3 zhgjidhja pa dhunë dhe mënjanimi

i konflikteve

### 3 Njohja dhe zbulimi

i paragjytimeve, ndërgjegjësimi

për rolet vajzë – djalë,

p.sh. në rreth bisedash,

me një shok ose në grup,

fëmijët si ndihmës për fëmijët, marrja

dhe futja e temave shoqërore

në mësim

Seite 18

## ETIKA, BESIMI DHE SHOQËRIA NË ARSIM

„Është ky një vendim i drejtë?, „ Kush është

zoti dhe a e ka parë njeri atë? Fëmijët

preokupohen me pyetjet themelore të jetës.

Në kërkim të përgjigjeve kërkojnë modele

dhe shoqërim nga prindërit me thesarin  
e përvojës dhe dijes së tyre.

### **Mendimi im vlerësohet**

Për fëmijët është e rëndësishme të përjetojnë  
faktin, që në familje, në kopësht dhe në shkollë,  
idetë e tyre kanë vlerë. Ata mësojnë kështu  
që të formojnë mendimin e tyre personal, të  
pranojnë mendimin e tjetrit si dhe të mbrojnë  
të drejtat e tyre si dhe ato të tjerëve.

### **Çfarë ka rëndësi për mua**

Në çdo familje ka vlera, qëndrime dhe rregulla  
të caktuara, që vlerësohen si të rëndësishme.  
Në kopësht, fëmijët njihen me një sistem tjetër  
vlerash, që mund të jetë i ndryshëm nga ai në  
familje. Kështu ata ballafaqohen me norma  
të ndryshme të qëndrimit. Nëqoftëse fëmijët,  
ndjehen të pranuar në sistemin e vlerave  
familjare, e kanë më të lehtë të ndeshen  
në mënyrë kritike edhe me vlerat dhe normat  
e të tjerëve. Në këtë mënyrë zhvillohet  
dhe etika themelore e të mirkuptuarit.

### **Çdonjëri është njësoj i barabartë**

Fëmijët janë vëzhgues të saktë. Ata shikojnë  
se si trajtohen në familje dhe në kopësht

njerzit që janë „ndryshe“ nga të tjerët. Në kopësht i kushtohet rëndësi faktit që të gjithë fëmijët, me të gjitha ndryshimet e tyre si dhe me të gjitha dhuntitë e tyre, të shikohen si pjesë e vlerësuar e grupit. Në një atmosferë të tillë, ku ndryshimet shikohen si vlera, mund të zhvillohet ndjenja e përkatësisë dhe sigurisë.

### **Shumëllojshmëria është pasurim**

Kopështi, si pasqyrë e shoqërisë afron shumë shanse për konfrontimin me shumëllojshmërinë kulturore dhe atë besimtare. Puna ndërkulturore dhe ndërbesimtare inkurajon ato proçese mësimore që kanë të bëjnë me fëmijët me kulturë dhe besim fetar të ndryshëm. Ajo zbulon ndryshimet dhe të përbashkëtat dhe që i bën ato të mundura të bashkohen me çiltërsi dhe interes.

„FËMIJËT MENDOHEM

PËR BOTËN

QË NA RRETHON“

## „PËRVOJA E LOJËS DHE E MËSIMIT NË KOPËSHT”

### 3 Të kuptuarit e faktit që

çdo njeri është njësoj i vlefshëm,  
akceptimi shumëllojshmërisë  
si pasurim (libra me figura, tregime,  
veprimi model i të rriturve)

### 3 Njohja me sjellje dhe qëndrime

demokratike (vendimi i grupit për  
problemet, mendimi personal dhe  
sjellja e ideve,.....)

### 3 Pjesmarrja aktive në vendimet

shoqërore (marrja e vendimeve të  
përbashkëta, marrja e përgjegjësisë)

### 3 Përjetimi i festave fetare,

njohja me tregime fetare

### 3 Takim i hapur me kultura

të ndryshme (libra me figura, këngë  
në gjuhë të ndryshme, festa, të  
ngrëna, njohja me veshjet të  
ndryshme popullore,.....)

## KËSHTU E NDIHMONI FËMIJËN

## TUAJ NË FAMILJE

3 Jepini fëmijës tuaj mundësinë, që në bazë të moshës, për disa gjëra të vendosi vetë ose të vendosi edhe ai sëbashku me familjen p.sh.Çfarë dhe sa dua unë të ha?,Çfarë dua unë të vesh?, Çfarë shokësh dua unë të ftoj? Vendorsja sëbashku e nje pikniku,.....

3 Marrja përsipër e detyrave dhe detyrimeve të vogla, forcon vetbesimin dhe përgjegjësinë e fëmijës tuaj, p.sh. heqja e pjatave,ujitja e luleve,ushqyerja e maces, vendorsja e lojrave në vënd,.....

3 Pyesni fëmijën tuaj për mendimin e tij,p.sh.Çfarë të ka pëlqyer ose nuk të ka pëlqyer? Çfarë mund ta bëjmë ndryshe?

3 Flisni me fëmijën tuaj për gjërat tuaja të rëndësishme. Ju si prindër jeni model i rëndësishëm për zhvillimin e normave dhe vlerave shoqërore

## DETYRAT MËSIMORE

### DHE ZHVILLUESE

### NË SHKOLLË

- 3 Avancimi i atyre njohurive,  
aftësive dhe qëndrimeve,  
që janë bazë kryesore për  
pjesmarrjen aktive në shoqërinë  
demokratike si dhe për një  
bashkjetesë paqësore
- 3 Tolerimi dhe pranimi por dhe  
zhvillimi i aftësisë për një kufizim  
të argumentuar kundrejt mënyrave  
dhe formave të tjera të veprimit
- 3 Të gjeturit dhe përmbajturit,  
e rregullave të lojës dhe të punës
- 3 Marrja pjesë në shoqëri,  
të kryerit sëbashku të punëve
- 3 Kujdesi për mirësjelljen (të ndihmuarit,  
të dëgjuarit, të marrit në konsideratë  
të njëri – tjetrit,....)
- 3 Pjesmarrje aktive në shoqërinë  
shkollore

## GJUHA DHE KOMUNIKIMI NË ARSIM

Të mësuarit e gjuhës dhe të folurit është një proces kompleks, që fëmijët e përshkojnë në një kohë të habitëshme. Në gjashtë vitet e para të jetës, fëmijët përvetësojnë një fjalor prej 24.000 fjalësh prej të cilit përdorin rreth 5.000 fjalë

### **Si e mësojnë fëmijët gjuhën?**

Në vitet e para të jetës së një fëmije, janë prindërit, vllazërit dhe motrat modelet më të rëndësishme të gjuhës. Gjatë lojrave të përditëshme dhe të folurit me njeri – tjetrin, ndërtohen në tru strukturat dhe lidhjet, që janë vendimtare për zhvillimin e gjuhës dhe më vonë të mësuarit në shkollë.

### **Zhvillimi i gjuhës në kopështin e fëmijëve**

#### **Iuan një rol vendimtar**

Pedagogët e ndihmojnë fëmijën tuaj qëllimisht, që ai të zgjerojë fjalorin dhe të shprehurit e tij. Për këtë arsye afrohen në kopësht një sërë mundësish:  
në biseda me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit,



në tregime, në këngë, në histori dhe vjersha,  
gjatë rregullave dhe konflikteve, gjatë ngrënjes  
së përbashkët, gjatë lojës dhe gjatë lëvizjes.

### **Shumëgjuhësia si vlerë e çmuar**

Në momentin që fëmijët kuptojnë, që i njëjti send  
mund të thirret edhe me një emër tjetër, është vënë  
një gur themelor për mësimin e një gjuhe tjetër.

Fëmijët përfitojnë shumë, nëqoftëse që të vegjël janë  
të rrethuar nga gjuhë të ndryshme.

Për fëmijët që rriten me një ose me shumë gjuhë,  
është e rëndësishme që ju si prindër, të flisni me ta në  
gjuhën që ju vetë ndjeheni më mirë dhe që e  
zotëroni më mirë. Vetëm kështu mund të krijohet  
një bazë e rëndësishme për mësimin e çdo gjuhe  
tjetër si dhe asaj gjermane. Për një arsimim  
sa më të mirë, për lidhjen e shoqërisë si dhe  
për tu ndjerë mirë aty ku jeton, fëmijës tuaj  
i duhet të zotërojë gjuhën gjermane. Pedagoget  
dhe punonjëset ndërkulturore, do ta ndihmojnë  
fëmijën tuaj për përvetsimin e gjuhës së parë  
dhe asaj të dytë.

Fëmija juaj mëson në kopësht  
gjuhën gjermane, nëpërmjet lojrave  
dhe bisedave me fëmijët e tjerë  
si dhe nëpërmjet nxitjes qëllimore  
të pedagogëve.

## **Të mësuarit në formë loje**

### **të gjuhëve të huaja**

Trajtimi i gjuhëve të huaja në formën e lojës, krijon një bazë të vlefshme për mësimin e gjuhëve të huaja të tjera.

„GJUHA ËSHTË ÇELËSI  
I KOMUNIKIMIT DHE  
ARSIMIMIT“

Seite 21

## **PËRVOJA E LOJËS DHE MËSIMIT NË KOPËSHT**

### **Mbështetja gjuhësore**

#### **në jetën e përditëshme**

**3** Mbështetje gjuhësore e rrethit mësimor

(ofertë e pasur me literaturë për fëmijë, biseda, kërkimi i mundësive për të folur, prania e shumë gjuhëve)

**3** Shoqërimi gjuhësor i aktiviteteve

(emërtimi i sendeve, përshkrimi i veprimeve, biseda për ngjarjet)

## **Aktivite mësimore që**

### **kanë gjuhën si piksynim**

3 Të lexuarit, të treguarit,  
të shikuarit e librave me figura  
(zgjuarja e interesit për lexim,  
mendime dhe pyetje, gjatë  
dhe mbrapa leximit)

3 Biseda ne grupe të vogla

3 Tregime të krijuara vetë,  
theatër, vizatim

3 Biseda filozofike  
me fëmijët

3 Aktivitete dhe lojra në gjuhë të huaja

## **KËSHTU E NDIHMONI FËMIJËN**

### **TUAJ NË FAMILJE**

3 Merrni kohë për të biseduar  
me fëmijën tuaj, për ngjarjet, ndjenjat,  
konfliktet, planet, mendimet,....

3 I tregoni fëmijës tuaj tregime,  
i lexoni atij rregullisht diçka  
përpara se të flerë  
(natën - e mirë - tregime)

3 Ndërtoni gjatë ditës

këngë, vjersha, lojra me gishta

ose lojra në gjunjë

3 Kur të flisni me fëmijën tuaj,

duhet ta konsideroni atë

si të barabartë me veten

3 Dëgjojeni dhe e lini atë,

të thotë deri në fund mendimin

e filluar.

3 Vizitoni me fëmijën tuaj

një bibliotekë ose librari dhe

lejojeni atë, ti zgjedhi vetë librat

që i pëlqejnë.

3 Përmirësoni të folurën e fëmijës,

duke e përsëritur edhe një herë

fjalinë në mënyrë të drejtë.

(p.sh. „Babi është vjen“, thotë ai

„Po, babi ka ardhur“, thoni ju)

DETYRAT MËSIMORE

DHE ZHVILLUESE

NË SHKOLLË

3 Aktivizimi dhe zhvillimi më tej

i aftësive gjuhësore

3 Të folurit sipas situatës:

Përdorimi i situatave të të folurit

dhe shfrytëzimi i tyre në formë

loje, p.sh. të kërkuarit falje,

dhënja e informacioneve

3 Zhvillimi i dëshirës për të treguar,

për të ndarë si dhe për të dëgjuar

3 Mbajta e rregullave të thjeshta të bisedës,

mundësia e vendosjes në bisedë

e shprehjeve gjuhësore të mësuara

